

zgjdhura kafshësh dhe me një prodhim të madh kualitativ blegtoral.

A f ë r d i t a O n u z i, në artikullin interesant — *Një qendër e punimit të enëve prej dheu pa çark*, përveç të tjerash, vë në dukje punimin arhaik të enëve të ndryshme në fshatin German të rrethit të Burrelit, duke mos përdorur çarkun për këtë punë. Me këtë „industri” shtëpiake, siç thotë autorja, merren vetëm gratë. Materialin e mbledhur në terren, duke e plotësuar edhe me literaturën përkatëse, autorja e shtjellon në këto pika kryesore: nxjerrja e lëndës së parë, gatimi i saj, dhënia e formës, përgatitja për pjekje ose tharja, pjekja dhe „djegia”.

Mjeshtëria e poçerisë ka qenë shumë e përhapur ndër popujt e Ballkanit, kështu që edhe në të gjitha viset etnografike shqiptare të këtij gadishulli ka pasur poçarë të njohur. Me zhvillimin e industrisë, enët e dheut ua lëshojnë rrugën atyre të metalit e të porcelanës. Kjo zeje kaq e përhapur ndër ne nuk është studjuar sa duhet. A. Onuzi jep një kontribut të vlefshëm dhe një nxitje në këtë drejtim. Punimi është ilustruar me fotografi e skica përkatëse.

D i l a v e r K u r t i në artikullin e tij — *Zeja e punimit të barotit në krahinën e Matit* merret me një problem të rrallë nga veprimtaria materiale e popullit. Prodhimi i barotit ka qenë një mjeshtëri në zë në disa fshatra të Kryematit në shekullin e kaluar. Autori përshkruan me hollësi punishtet e barotit, që quhen „dinga”, teknikën e ndërtimit të tyre, lëndet e para

(salpetër, sqfuri, thëngjill lajthie) dhe përdorimin e barotit. Ai vë në dukje se armët e zjarrit u përdorën në truallin shqiptar qysh në kohën e Skënderbeut, ndërsa më vonë baroti prodhohej në vise të ndryshme të Shqipërisë. Në Mat „dingat” kanë ekzistuar deri në vitin 1910, kur këto i ndaloi dhe i rrënoi ushtria turke. Nga ana tjetër, baroti i Matit përdorej për armë që mbuseshin nga gryka, të cilat në këtë kohë u zëvendësuan me armë bashkëkohore, me fyshekë. Baroti i Matit shitej në tregje të shumë qyteteve (në Shkodër, Prizren, Gjakovë, Dibër etj.).

Artikulli i A b e d i n Ç a u s h i t — *Martesa në qytetin e Elbasanit*, është një kontribut i mirë për njohjen e dokeve dhe zakoneve të viseve dhe të qendrave të ndryshme shqiptare. I tillë është edhe artikulli i L l a m b r i n i M i t r u s h i q — *Zakone e rite të ceremonialit të vdekjes në Myzeqe*, i dokumentuar edhe me disa fotografi.

Në fund të këtij numri të Etnografisë Shqiptare, botohet një material shumë interesant jo vetëm për shkencën etnografike, por në përgjithësi për shkencat shoqërore, me titull — *Mitologji e besime në Myzeqe*, të cilin e ka mbledhur J a n i N u s h i. Parathënien dhe përgatitjen për botim të këtij materiali e bëri Mark Tirtja.

Numri V i revistës Etnografia Shqiptare, siç shihet, përmban studime, artikuj dhe materiale të pasura me një vlerë të madhe shkencore.

MARK KRASNIQI

ETNOGRAFIA SHQIPTARE, Nr. VI, Tiranë 1975

I gjithë ky numër i revistës shkencore etnografike u është kushtuar lojrave popullore shqiptare, të cilat i ka mbledhur në vise të ndryshme *Luigj Shala*, punonjës i dalluar në fushën e edukatës fizike dhe bashkëpunëtor i Sektorit të Etnografisë. Ai mblodhi 1250 lojra, nga të cilat këtu botohen 227 në 286 faqe të revistës. Në parathënien e shkurtë të Prof. Eqrem Çabejt vihet në dukje vlera e madhe e lojrave popullore, të cilat janë një pjesë e vlefshme e kulturës së tij dhe paraqiten tek të gjithë popujt që nga kohët më të lashta, me karakteristika të veçanta. Studjuesit e kulturës popullore shqiptare e kanë pasë lënë pas dore këtë element të rëndësishëm, këtë traditë pozitive të popullit tonë, e cila edhe në ditët tona duhet ta gjejë vendin në jetën

tonë të përditshme, sidomos në shkolla dhe në organizata të rinisë.

Këtu, përveç të tjerash, bie në sy interesimi i gjithanshëm dhe puna e palodhshme e *Luigj Shalës* për të mbledhur këtë begati të kulturës kombëtare, gjë që shihet nga fakti se ai ka mbledhur lojra që nga Malësia e Madhe e deri në Sarandë, që nga Durrësi e deri në Pejë, Vuçitërnë, Mitrovicë dhe në fshatin Bllacë, në rrethinat e gjera të Prokupjes, në Toplicë. (Në faqen 27 emri Bllacë është shënuar gabimisht Placë, ndërsa në faqen 256 fshati Isniq është shënuar si Izmiq).

Botimi i lojrave popullore ka domethënie të madhe jo vetëm për studjuesit e folklorit shqiptar, por edhe për lingvistët, madje edhe për shkencën e mjekësisë dhe

për studimin e psikologjisë popullore. Por ajo që na duket më e rëndësishme ndër të gjitha është ana praktike e këtyre lojrave. Prandaj, një botim edhe më i gjerë se ky, me një tirazh shumë më të madh, i dedikuar masave të gjera të lexuesve, sidomos shkolla-

ve dhe brezit të ri në përgjithësi, do t'ishte më se i dobishëm, do të plotësonte një zbrazëti dhe do të kishte një aplikim të përditshëm në jetën praktike, sidomos në atë shkollore.

MARK KRASNIQI

